

VENDIM
Nr. 298, datë 20.4.2016

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË
TURIZMIT**

(Ndryshuar me VKM nr. 20¹, datë 18.1.2023; nr. 202, datë 4.4.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 12, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AGJENCISË

1. Agjencia Kombëtare e Turizmit është person juridik, publik, buxhetor, funksionon si institucion në varësi të ministrit përgjegjës për turizmin dhe ka si qëllim promovimin e turizmit shqiptar brenda dhe jashtë vendit.

2. Agjencia funksionon në përputhje me parimet dhe me dispozitat e ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe ushtron funksionin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar për turizmin dhe me politikat e strategjitë kombëtare në fushën e turizmit me qëllim promovimin dhe krijimin e identitetit të turizmit shqiptar nëpërmjet shfrytëzimit të të gjithë potencialit ekzistues turistik të vendit.

3. Agjencia e ka selinë qendrore në Tiranë dhe është e organizuar në nivel qendror.

4. Agjencia identifikohet me stemën dhe vulën zyrtare.

5. Stema e Agjencisë përbëhet nga stema e Republikës dhe përmban emërtimet “Republika e Shqipërisë”, të ministrisë përgjegjëse për turizmin, si dhe “Agjencia Kombëtare e Turizmit”.

6. Vula e Agjencisë përmban elementet e stemës, të përcaktuar në pikën 5.

7. *Marrëdhëniet e punës të drejtorit të përgjithshëm dhe të punonjësve të Agjencisë rregullohen sipas dispozitave të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar.*

8. Agjencia funksionon duke ushtruar kompetencat e mëposhtme:

8.1 Zbaton Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Turizmit dhe Strategjinë Kombëtare të Marketingut për sektorin e turizmit.

8.2 Zbaton politikat e marketingut në fushën e turizmit, duke promovuar turizmin shqiptar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, për krijimin e imazhit të Shqipërisë si destinacion turistik në tregun ndërkombëtar.

8.3 Ofron informacion, si dhe krijon infrastrukturën e nevojshme për dhënien e informacionit për vizitorët, udhëtarët dhe turistët në lidhje me kapacitetin turistik kombëtar, shërbimet turistike që ofrohen, për produktet dhe destinacionet turistike, si dhe për veprimtari të tjera të dobishme në lidhje edhe me aspekte dhe vlera të natyrës, historisë dhe trashëgimisë së kombit shqiptar apo me veprimtari shoqërore e kulturore, të cilat kanë si objekt informimin dhe tërheqjen e turistëve e të vizitorëve.

8.4 Në kuadër të promovimit të modeleve të shërbimeve të turizmit në vend, krijon dhe zhvillon një markë cilësie me qëllim bërjen të njohur të produkteve e të shërbimeve turistike të ofruara, si dhe forcimin e besimit të konsumatorëve ndaj cilësisë së shërbimeve turistike të ofruara dhe të operatorëve që i ofrojnë ato.

8.5 Bashkëpunon me institucione të tjera për të zhvilluar aktivitetin e saj brenda dhe jashtë vendit.

¹ VKM nr. 20, datë 18.1.2023 në pikën 2 shprehet;

² 2. Për nëpunësit aktualë të Agjencisë Kombëtare të Turizmit, që gëzojnë statusin e nëpunësit civil, zbatohen dispozitat e legjislacionit për nëpunësit civil në rastin e mbylljes dhe të ristrukturimit të institucionit.”

8.5/1. *“Harton, në bashkëpunim me institucionet qendrore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe grupet e interesit në fushën e turizmit, kalendarin turistik të aktiviteteve zbatuese, duke i orientuar ato për shtrirjet gjeografike, si dhe për tematikën e eventeve të preferuara për turistët në këto zona dhe duke koordinuar njëkohësisht edhe realizimin e këtij kalendari.*

8.5/2. *Orienton, koordinon dhe promovon kalendarin turistik, si dhe monitoron ndjekshmërinë nga publiku të aktiviteteve të këtij kalendari.*

8.6 Ndërmerr dhe nxit projekte për turizmin, sipas fushës së vet të veprimtarisë, duke marrë miratimin paraprak të ministrit. Agjencia aplikon për financime pranë Bashkimit Evropian dhe donatorëve apo pranë institucioneve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, me qëllim realizimin e projekteve.

8.6/1. *Financon nga fondi buxhetor i miratuar për çdo vit realizimin e projekteve të cilat kanë karakter krijues e me objekt të veprimtarisë së tyre turizmin, si dhe ngjarje që janë të përfshira në kalendarin turistik, pas miratimit të ministrit.*

8.6/2. *Monitoron zbatimin dhe realizimin e projekteve me karakter krijues, të cilat kanë për qëllim promovimin e turizmit, si dhe të ngjarjeve që janë të përfshira në kalendarin turistik, të financuara nga fondi buxhetor i miratuar.*

8.7 Promovon, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, produktet turistike dhe destinacionet turistike shqiptare, duke bashkëpunuar me zyrat rajonale të turizmit, komitetet rajonale për zhvillimin e turizmit, pushtetin vendor, operatorët dhe agjencitë turistike, si dhe organizma të tjerë që operojnë në fushën e turizmit, përfaqësitë diplomatike shqiptare jashtë vendit, me përfaqësitë diplomatike të huaja brenda vendit apo me organizata të ndryshme vendase dhe të huaja apo edhe konsulentë. Promovon, gjithashtu, zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me turizmin apo të çdo aktiviteti tjetër kulturor a me karakter historik ose sportiv, i cili ndikon në promovimin e turizmit apo me tërheqjen e turistëve dhe vizitorëve.

8.8 Promovon, si brenda edhe jashtë vendit, me anë të informimit, shpërndarjes së informacionit, analizave, studimeve, prezantimeve, statistikave apo me çdo mjet tjetër të përshtatshëm, investimet në zonat me prioritet zhvillimin e turizmit, duke bashkëpunuar me institucionet publike të nxitjes së investimeve në vend, institucione të tjera publike, organizata të ndryshme vendase dhe të huaja apo edhe konsulentë.

8.9 Propozon dhe harton materialet me karakter promociional, informues apo statistikor, në përputhje me kërkesat, nevojat dhe tendencat e tregut turistik, me kërkesat dhe nevojat kombëtare e rajonale të zhvillimit të turizmit, me objektivat e planeve dhe strategjive kombëtare të turizmit, si dhe me tendencat e tregut turistik, dhe realizon prodhimin apo botimin e tyre.

8.10 Kryen, monitoron, përmirëson dhe përditëson aktivitetin e promovimit *on-line* me anë të portalit *on-line*, si dhe forumeve dhe kanaleve sociale *on-line*.

8.11 Mbledh të ardhurat që realizohen në bazë të marrëveshjeve të qirasë për sipërfaqet e dhëna në përdorim për zhvillimin e turizmit dhe të marrëveshjeve ekzistuese të qirasë të lidhura me subjektet “person i stimuluar”. Mënyra e mbledhjes dhe e përdorimit të këtyre të ardhurave nga Agjencia përcaktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit të Financave në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për turizmin, sipas legjislacionit në fuqi.

8.12 Kontrollon zbatimin dhe plotësimin e kriterëve për marrëveshjet ekzistuese të qirasë dhe për marrëveshjet e zhvillimit, të lidhura me subjektet “person i stimuluar”. Rregulla të hollësishme për zbatimin e kësaj pike përcaktohen me udhëzimin e ministrit përgjegjës për turizmin.

8.12/1. *Krijon të ardhura dytësore nga pagesat e subjekteve të cilave u ofrohet shërbimi i promovimit të aktiviteteve të tyre në hapësirat e menaxhuara nga Agjencia Kombëtare e Turizmit.*

8.13 I propozon ministrit përgjegjës për turizmin ndryshimin e akteve ligjore e nënligjore në fushën e turizmit, duke argumentuar arsyet për këto propozime.

II. DREJTORI I AGJENCISË KOMBËTARE TË TURIZMIT

1. Agjencia drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili administron e drejton veprimtarinë e përditshme të saj dhe e përfaqëson atë në marrëdhëniet me të tretët si dhe përgjigjet para ministrit përgjegjës për turizmin.

2. Drejtori ushtron të gjitha kompetencat për drejtimin e veprimtarisë së Agjencisë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me funksionet e objektivat e Agjencisë.

3. Drejtori propozon rregulloren e brendshme të funksionimit të Agjencisë për miratim të ministrit përgjegjës për turizmin.

4. Drejtori bashkërendon punën midis strukturave të tjera brenda Agjencisë dhe cakton detyra dhe objektiva përkatës për t'u realizuar nga këto struktura.

5. Drejtori bashkërendon punën për hartimin e projektbuxhetit, sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara në ligjin organik për buxhetin e shtetit, të cilin ia paraqet për miratim ministrit që mbulon fushën e turizmit.

6. Propozon programin vjetor të veprimtarive të Agjencisë, të cilin ia paraqet për miratim ministrit përgjegjës për turizmin.

7. Nxjerr urdhra dhe udhëzime të brendshëm, në bazë të të cilëve strukturat e Agjencisë dhe punonjësit në përbërje të tyre të marrin masat për përmbushjen sa më mirë të detyrave e të objektivave të Agjencisë dhe me qëllim disiplinimin e aktivitetit të saj.

8. Kontrollon mbarëvajtjen e aktivitetit të Agjencisë me qëllim arritjen e objektivave të përcaktuar dhe realizimin sa më të plotë të funksioneve të saj, si dhe merr masat e nevojshme për koordinimin sa më mirë të punës ndërmjet strukturave të Agjencisë.

9. Informon rregullisht në lidhje me mbarëvajtjen e aktivitetit të Agjencisë dhe realizimin e funksioneve të saj ministrin përgjegjës për turizmin, të cilit i jep llogari për aktivitetin e saj.

III. ORGANIZIMI FINANCIAR

Administrimi dhe veprimtaria financiare auditohen nga ministria përgjegjëse për turizmin dhe institucionet e tjera të ngarkuara me ligj për auditimin.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Vendimi nr. 571, datë 5.9.2007, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e statutit të Agjencisë Kombëtare të Turizmit", shfuqizohet.

2. Ngarkohen *Ministria e Turizmit dhe Mjedisit* dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama